

LIGJ
Nr.8333, datë 23.4.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 "PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7653, DATË 23.12.1992; NR.7723, DATË 21.6.1993; NR.7925, DATË 19.4.1995 DHE LIGJIN NR.8159, DATË 7.11.1996

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", ndryshuar me ligjet nr.7653, datë 23.12.1992; nr.7723, datë 21.6.1993; nr.7925, datë 19.4.1995 dhe ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, në nenin 22, pika 2 ndryshohet si vijon:

"Prona shtetërore jepet me qira nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ministritë, institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, organet përkatëse të pushtetit lokal që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore, si dhe ndërmarrjet ose shoqëritë tregtare shtetërore.

Kriteret për dhënien me qira të pronës shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. "

Neni 2

Në nenin 8 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, fjalët: "të nënshkruajë kontratata të reja për dhënien me qira të objekteve", shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2081, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani